



## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - koleji i përbërë nga gjyqtarët; Mejreme Memaj, kryetare, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit Xh. R., për shkak të veprës penale vrasje nga neni 172 të KPRK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPR, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.76/2023 datë 08.03.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.244/2023 datë 21.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me 16.01.2024, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit Xh. R. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.76/2023 datë 08.03.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.244/2023 datë 21.09.2023.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.76/2023 datë 08.03.2023, të dënuarin Xh. R. e ka shpallur fajtor për veprën penale vrasje nga neni 172 të KPRK dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPR, ashtu që për veprën e parë penale i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) vjet, kurse për veprën e dytë penale i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj. Në pajtim me nenin 76 të KPRK, të dënuarin Xh. R. , e ka gjykuar me dënim unik me burgim në

kohëzgjatje prej 21(njëzet e një) viteve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Të dënuarit në dënimin e shqiptuar i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 16.07.2021. Të dënuarit i është vazhduar masa e paraburgimit nga data 27.02.2023, ashtu që dënimin do ta mbaj deri në përfundim, por jo më gjatë se koha e dënimit të shqiptuar me burgim, sipas aktgjykimit.

Është urdhëruar konfiskimi i revoles të markës “E. S.”, dhe dy fishekë. Është urdhëruar Policia e Kosovës, që ta bëjë shkatërrimin e armës në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Prishtinë, pasi të vërtetohet se kjo armë nuk është përdorur në ndonjë krim tjetër.

I dënuari është obliguar që ti paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, dhe atë në emër të ekspertizës së Institutit të Forenzikës shumë prej 450 €, paushallin gjyqësor në shumë prej 100 €, kurse në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 50 €. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.244/2023 datë 20.09.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ankesën e të dëmtuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit av. Shkodran Manaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës aktgjykimet e kundërshtuara t’i ndryshoi dhe të bëhet rikualifikimi juridik i veprës penale nga vepra penale e vrasje nga neni 172 të KPRK, në veprën penale vrasje nga pakujdesia nga neni 175 të KPRK, apo aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja ti kthehet në rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit me parashtrësën KMLP.II.nr.413/23 dt. 29.12.2023, me propozim që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat të çështjes konform dispozitës së nenit 435 paragrafi.1 dhe 436 paragrafi.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën e mbrojtësit të dënuarit, pretendohet se aktgjykimet e gjykatave janë marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 e lidhur me nenin 7 paragrafi 1 dhe nenin 360 paragrafi 2 të KPRK, për faktin se gjykatat vendimin e kanë marr duke mos arsyetuar provat për të cilin të dënuarin e kanë shpall fajtor për veprën penale. Gjykata nuk kanë arritur të vërtetojnë dilemën dhe mëdyshjen lidhur me formën e fajësisë së kryerësit dhe në rastin konkret bazuar në parimin në fjalë mëdyshjet lidhur me

ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të dënuarit. Më tutje në kërkesë theksohet se nga deklaratat e dëshmitarëve është vërtetuar që në mes të dënuarit dhe tani të ndjerit kanë ekzistuar raporte të mira, tregon bindshëm dhe me logjikë të arsyeshme se vrasja e të ndjerit, ka ndodhur nga pakujdesia e assesit me dashje. Më tutje në kërkesë mbrojtësi vlerëson se aktgjykimi i kundërshtuar, është përfshirë edhe me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 lidhur me nenin 369 paragrafi 6 dhe 7 të KPRK , e cila shkelje ka ndikuar në marrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm, ngase gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë nuk i kanë paraqitur në mënyrë të qartë arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, në arsyetimin e aktgjykimit nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh konsiderohen të vërtetuara apo të pavërtetuara, nuk e kanë bërë vërtetimin e saktësisë së provave kundërthënëse, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjes juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të dënuarit.

Pretendohet në kërkesë, se aktgjykimi i kundërshtuar është i përfshirë edhe me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 lidhur me nenin 368 paragrafi 8 të KPRK ngase te dy gjykatat me rastin e vendimit për dënim, nuk kanë dhënë arsye se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh të dënuarit i është shqiptuar dënim kaq i lartë.

Në kërkesën e mbrojtësit të dënuarit pretendohet se bazuar në ato që u theksuan më lartë, në asnjë provë nuk vërtetohet se i dënuari me dashje e ka privuar nga jeta të ndjerin Sh. L., dhe si rrjedhojë në këtë çështje penale, është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit sepse po të zbatohet drejt ligji penal, do të konstatohej se në veprimet e të dënuarit janë konsumuar elementet e veprës penale vrasje nga pakujdesia nga neni 175 i KPRK.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të dënuarit se aktgjykimet janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal janë të pabazuara. Siç rezulton nga shkresat e çështjes, aktgjykimi i shkallës së parë i vërtetuar me aktgjykimin e shkallës së dytë, është i qartë dhe konkret, ngase në dispozitiv janë paraqitur të gjitha veprimet inkriminuese të dënuarit që përbëjnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye për faktet vendimtare duke vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse, duke dhënë arsye të mjaftueshme në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje juridike e posaçërisht me rastin e vërtetimit të veprës penale ashtu siç e ka kualifikuar gjykata e shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i kundërshtuar rezulton se i dënuari me datën 15.07.2021, rreth orës 22:00 h në rrugën "... " në G. të U., Komuna e L., i dënuari Xh. R., për shkak të mosmarrëveshjes që kishte pasur rreth 10 ditë më parë rreth fëmijëve dhe mosmarrëveshjes verbale në ditën kritike me tani të ndjerin Sh. L., me dashje që ta privoj nga jeta, ka shkuar në shtëpinë e tij e ka marrë armën e tipit " E. S. ..." dhe ka dalur në rrugë ku e ka pritur të ndjerin

dhe pasi e ka takuar ka shtënë dy herë në drejtim të tani të ndjerit Sh. L., duke e goditur në regjionin e kokës, ku si pasojë e plagëve ka vdekur në vendin e ngjarjes.

Gjykata e shkallës së parë, me administrimin e provave-dëgjimin e dëshmitarëve, Q. L.1, B. L., Q. L.2, I. D., R. D. dhe provave materiale raportit të autopsisë, ekspertizës për gjendjen mendore të të dënuarit të përpiluar nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike, drejtë ka vërtetuar se në veprimet e të dënuarit Xh. R., janë formuar të gjitha elementet e veprës penale vrasje nga neni 172 të KPRK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK,

Dëshmitë e dëshmitarëve të lartcekur e të cilët janë dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor, për gjykatën ishin dëshmi me besueshmëri të plotë, ngase deklaratat e këtyre dëshmitarëve ishin të përputhshmëri të plotë edhe me provat e tjera si me provat materiale për faktet relevante, për të cilat prova gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetim të plotë dhe të qartë, të cilën e mbështet edhe kjo gjykatë.

Nga raporti i autopsisë për të ndjerin Sh. L., i lëshuar nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore në P., është vërtetuar fakti se i ndjeri, natën kritike ishte goditur nga dy predha me armë të zjarrit.

Me raportin e ekzaminimit psikiatrik të lëshuar nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë- është konstatuar se te i dënuari Xh. R. në momentin e kryerjes së veprës penale, nuk konstatohet çrregullim mendor, sëmundje mendore apo ngecje në zhvillimin mendor, llogaritshmëria për veprën ka qenë e ruajtur. Pra i dënuari në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm ( çka nënkupton se ka qenë i aftë ti kuptojë sjelljet dhe veprimet e tij.

Gjykata po ashtu i ka falur besimin e plotë provave materiale që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, dhe atë raportit të autopsisë, raportit të ekzaminimit psikiatrik, procesverbalit nga vendi i ngjarjes dhe provave të tjera si në shkresat e lëndës.

Gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vërtetuar se raportet në mes të dënuarit dhe tani të ndjerit kanë filluar të përkeqësohen afërsisht 10 ditë para ngjarjes kritike pas ngacmimit të fëmijëve të të ndjerit nga fëmijët e të dënuarit. Problemet kishin vazhduar po ashtu edhe natën kritike diku 2 orë para vrasjes së të ndjerit, kur kishin pasur një përleshje verbale në mes të dënuarit dhe të ndjerit dhe i kishte ndarë dëshmitari Q.L.2.

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se i dënuari ditën kritike paraprakisht kishte marr veprime me dashje të cilat i mundësuan më vonë vrasjen e tani të ndjerit. Fillimisht pas fjalosjes që kishte pasur me të ndjerin kishte shkuar në shtëpi e kishte marr armën e zjarrit të llojit “ E. S. .. “ dhe municionin për të kryer vrasjen. Për këtë qëllim kishte dalur në rrugë dhe e kishte pritur të ndjerin për tu kthyer nga dyqani për ta privuar nga jeta, i dënuari me dashje si dhe me qëllim që ta privoj nga jeta të ndjerin me armën e tij të llojit “E. S...” shtënë (qëllon) në drejtim të ndjerit Sh. L. ku me dy predha e godet në regjionin e kokës, dhe vdekja e të ndjerit ka ardh si pasojë e fashitjes së trurit si dhe gjakderdhjes së jashtme.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, të pabazuara janë pretendimet e mbrojtësit të dënuarit se i dënuari veprën penale e ka kryer nga pakujdesia. Ky pretendim nuk qëndron sepse në rastin konkret përveç me provat që u arsyetuan në këtë aktgjykim si më lartë vërtetohet se i ndjeri ka dy plumba në pjesën e kokës. Kjo tregon se i dënuari kishte përzgjedhur vendin më të përshtatshëm për shkaktimin e pasojës pra, për ta privuar nga jeta të ndjerin, kjo tregon edhe dashjen e tij të kjo veprën penale. Fakti se ai kishte pasur një mosmarrëveshje verbale rreth 2 orë para ngjarjes kritike, dhe i dënuari kishte shkuar dhe e kishte marr armën në shtëpi ka ekzistuar një interval kohor, që tregon se vrasja nuk ka qenë nga pakujdesia.. Shtrohet pyetja, nëse i dënuari nuk kishte dashjen dhe qëllimin për ta privuar nga jeta të ndjerin, atëherë cila është arsyeja, që e kishte marr armën dhe municionin në shtëpi, dhe e kishte pritur viktimën. Veprimet që i kishte marr i dënuari duke marr armën në shtëpi, daljen në rrugë për ta pritur të ndjerin pastaj ka shtënë dy herë ku dy fishekët është vërtetuar se e kanë goditur të ndjerin në kokë, të gjitha këto veprime tregojnë dashjen e të dënuarit sepse dy fishekët e kanë goditur në kokë e jo në pjesët tjera, pra i dënuari e kishte zgjedhur vendin për ta goditur të ndjerin.

Pakujdesia ekziston atëherë kur personi është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit apo mosveprimit të tij, por me mendjehetësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet, apo se ai do të mund të parandalojë shkaktimin e saj. Ndërsa në rastin konkret kjo formë e fajit nuk është vërtetuar nga provat e administruara, por siç u theksua më lartë nga gjitha provat është vërtetuar se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të dashjes direkte nga neni 172 të KPRK.

Gjykata Supreme vlerëson se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, ndërsa pretendimi i mbrojtësit se me aktgjykimet e kundërshtuara është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit nuk qëndrojnë, ngase me të gjitha provat e administruara janë vërtetuar elementet inkriminuese të veprave penale për të cilat është shpallur fajtor i dënuari.

Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë theksuar të gjitha rrethanat që kanë ndikuar në shqiptimin e llojit dhe lartësisë së dënimit e po ashtu edhe janë renditur rrethanat lehtësuese dhe rrethanat rënduese të cilat janë marrë për bazë lidhur me shqiptimin e dënimit. Përndryshe, duhet theksuar faktin se nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimeve të shqiptuara, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkaluar kompetencat ligjore dhe se në rastin konkret Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar në suaza të dispozitave të lartcekura për veprën penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor, kështu që pretendimet e mbrojtësit në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385, paragrafi 5. të KPP, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet vetëm në rastet kur gjykata i ka tejkaluar kompetencat ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit, ndërsa në rastin konkret nuk ka ndodhur një gjë e tillë.

Në rast se nuk është fjala për këtë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjykimit është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërlidhej me mungesën ose paqartësitë e arsyeve lidhur me vendimin për dënimin, mirëpo, në rastin konkret një pretendim i këtillë në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është paraqitur.

Nga arsyet e dhëna më sipër kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është refuzuar si e pabazuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 437 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

PML.nr.699/2023 datë 16.01.2023

Procesmbajtësi ,  
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,  
Mejreme Memaj